



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA PËR STUDIME PASUNIVERSITARE NË KORENË E JUGUT

Shkolla KDI për "Politikat dhe Menaxhimin Publik" në Korenë e Jugut, (*KDI School of Public Policy and Management*), për vitin akademik 2017-2018, ofron bursa studimi për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të kryejnë studimet pasuniversitare në programet e studimit Master në fushat e mëposhtme:

- Master për Politikat Publike (Master of Public Policy, MPP);
- Master për Politikat e Zhvillimit (Master of Development Policy, MDP);
- Master për Menaxhimin Publik (Master of Public Management, MPM);

Misioni i kësaj shkolle është të trajnojë dhe përgatisë drejtues të së ardhmes në sektorët publikë dhe privatë, të cilët përshtaten plotësisht me ndryshimet ekonomike. Shkolla KDI për "Politikat dhe Menaxhimin Publik" mundëson një kombinim të shkëlqyer të njohurive të fituara bashkëkohore akademike dhe zbatimit të tyre në praktikë në kuadër të risive dhe prioriteteve kyçe të vendosura nga politikat kombëtare.

Programi i Bursave të Qeverisë Koreane (Korean Government Scholarship Program-NIIED GKS-KGSP) për studentët ndërkombëtarë sponsorizohet nga Instituti Kombëtar për Arsimin Ndërkombëtar (NIIED) dhe synon të promovojë shkëmbimin ndërkombëtar dhe partneritetet të ndërsjellë midis vendeve pjesëmarrëse.

Kandidatët pasuniversitare që dëshirojnë të ndjekin këto studime duhet të kenë kualifikimin e domosdoshëm për t'u pranuar në shkollën KDI. Ata duhet të kenë përfunduar studimet në programe bachelor ose master pranë universiteteve ose shkollave të larta në Republikën e Shqipërisë ose jashtë vendit. Kandidatët, gjithashtu, duhet t'i nënshtrohen testimit ndërkombëtar: TOEFL, IELTS, ose TOEIC, duke qene se kurset zhvillohen në gjuhën angleze.

Shpenzimet e udhëtimit, tarifat e shkollimit si dhe bursa mujore do të mbulohen nga Instituti Kombëtar për Arsimin Ndërkombëtar (NIIED), në kuadër të Programit të Bursave të Qeverisë Koreane (Korean Government Scholarship Program-NIIED GKS-KGSP).

Për një informacion më të detajuar për kushtet e aplikimit për bursat e shkollës KDI, referojuni informacionit bashkëlidhur këtij njoftimi ose adresave në vijim:

Admissions Office
KDI School of Public Policy and Management
263 Namsejong-ro, Sejong, 30149,
Republic of Korea
Tel: 82-44-550-1281 or 1220 ;
E-mail: internationaladmissions@kdis.ac.kr
Website: <http://admissions.kdischool.ac.kr>

Afati i fundit për aplikim është **data 20 mars 2017.**

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE